

RAMAZANI PARAPRIHET ME TË MIRË NË VUSHTRRI

Sot, në një solemnitet rasti, dy familje qe për katër vite e gjysmë ishin në armiqësi, ia shtrinë dorën njëra tjetrës për pajtim. Ceremonia e pajtimit qe nën patronatin e KK-Vushtrri, respektivisht Kryetarit Bajram Mulaku. Ndërsa si mysafir special i kësaj ceremonie qe Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri, i përfaqësuar nga Kryetari zt. Shemsi Rrahimi -*kryetar*, zt. Sedat Islami -*sekretar*, zt. Sadik Hasani -*mual-lim* dhe veterani Ferat ef. Gërguri. Këshilli i Bashkësisë Islame qe ftuar që në këtë ceremoni të ketë fjalën, të cilën e mbajti Kryetari Shemsi ef. Rrahimi.

Ja teksti i fjalimit:

Bismil-lahi'rr Rrahmani'rr Rrahim

Elhamdulil-lahi Rabbi'l alemine

Ve's salatu ve's selamu ala eshrefi'l enbijai ve'n murseline, ve bad'u:

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar, Krijuesit dhe Sunduesit Suprem kurse përshëndetjet qofshin mbi zotërinë e njerëzimit, mbi vulën e profetëve, mbi atë që Allahu i Madhëruar e dërgoi mëshirë dhe udhëzim për të gjitha botet!

E nderuara Familja Mehulli,

E nderuara Familja Salihu,

I nderuari Këshilli i Pajtimit,

I nderuari Kryetar i Komunës se Vushtrrisë,

Vëllezër dhe motra!

Koincidenca e këtij gjesti madhështor, e këtij humaniteti, e kësaj shpirtmadhësie, me muajin e Ramazanit, me muajin e vlerave dhe virtyteve, me muajin e pastrimit shpirtëror, me muajin e ngadhënjimit mbi te keqen, mbi epshin, është vërtetë për tu lavdëruar. Po kështu, është një rastësi, qe ne raport me rrjedhat neper te cilat po kalon vendi kur më së shumti i duhet uniteti dhe bashkimi, jep një shprese se Kosova ende ka kapacitete shpirtërore dhe etike për të përballuar sfidat, çfarëdo që të jene ato!

E nderuara familja Mehulli!

E di se humbja e një familjari është e rëndë dhe e vështirë për tu përballuar por me besoni se falja nuk është dobësi, përkundrazi. I forte – thoshte Muhammedi, alejhi's selam – është ai qe përmban veten kurse një i urte pati thënë: Falja është arma e te fortëve. Ndoshta këtu qëndron sekreti pse Muhammedi, alejhi's selam, u betua: "...dhe betohem se Allahu i Madhëruar robit për falje nuk i shton tjetër veçse krenari" (Tirmidhiu).

E nderuara familja Mehulli!

Nëse doni ta kuptoni peshën e veprës qe jeni duke bere sot, ju lutem referojuni fjalës se Allahut të Madhëruar në Kur'an:

وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَاثِمًا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا

...E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit ...” el-Maide, 32.

Ju sot nuk jeni duke falur një njeri, as një familje, as një fis, as një popull; jeni duke falur tere njerëzimin.

Ju sot jeni duke përvetësuar moralin e Jusufit, alejhi's selam qe me gjithë te këqijat dhe jetën e hidhur qe pati prej vëllezërve, kur erdhi ne pozitën qe kishte pushtet për ti shkatërruar jo vetëm ata dhe familjet e tyre por edhe shume me shume, ai nuk harroi te falte. I tille ishte edhe Muhammedi, alejhi's selam.

E nderuara familja Mehulli!

Sikur sot këtë eveniment - po e quaj kështu – ta përcillte e tere bota, sikur këtë salle te vogël ta ndanin me ne tere gazetaret e botes, prapëseprapë, dikujt do t'i kalonte pa e përcjellë. Dikush do te mund te mos dinte për dinjitetin tuaj, por kështu puna nuk do te jete ne boten e mëpastajme. Kështu, nuk do te ndodhe ne Ditën e Llogarisë, ne ditën kur krenaria dhe poshtërimi do te kenë kuptimet e vërteta. Them kështu ngase krenare para Allahut të Madhëruar janë vetëm ata qe për hire te Tij kane sakrifikuar, janë flijuar, janë vetemohuar, derisa te poshtëruar dhe te lige do te jene mëkatarët. Paramendojeni këtë insert te Ditës se Llogarisë, qe me lejen e Allahut të Madhëruar edhe ju do te jeni protagoniste te tij. Muhammedi, alejhi's selam përshkruan e thotë: Ai qe përmban veten (fal) atëherë kur ka mundësi ndëshkimi, ne Ditën e Kiametit para te gjitha krijesave Allahu i Madhëruar do e thërret qe te zgjedh nga mirësitë e Xhennetit – hyritë- atë qe do! (Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibni Maxheh)

Atë eveniment nuk do te mbetet krijese pa e përcjelle!

E nderuara familja Mehulli!

E nderuara familja Salihu!

Te nderuar vëllezër dhe motra pjesëmarrës!

Me lejoni qe përmbylljen e këtij fjalimi ta beje me një lutje drejtuar te Madhit Allah, qe meqenëse jemi ne vigjilje te Muajit te ramazanit, muaj ky ku behet çregjistrimi nga Xhehennemi, falja e besimtareve nga Xhehennemi, Allahu i Madhëruar ta fal rahmetliun, juve familje te nderuara dhe gjithë neve te tjerëve!

Dhashtë Zoti e fjalët vrasje, mbytje, dhunim, plaçkitje, korrupsion fshihen nga fjalori ynë dhe zëvendësohen me paqe, harmoni, lumturi, rend, siguri, drejtësi!

Krejt për fund, më lejoni të shfrytëzoj rastin tu urojë dhe Muajin e Bekuar të Ramazanit!

Paqja, mëshira dhe dhuntitë e Allahut të Madhëruar qofshin mbi ju!

Wes selamu alejkum!